



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:309015  
Datë: 09.11.2024  
Numri i dokumentit: 06429843

C.nr.3844/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses H.G nga Vushtrria, të cilën e përfaqëson R.M avokat nga Vushtrria, rruga “...” nr.78, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensim i diferencës në pension për shkak të inflacionit, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seance, me datë 08.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, SHPALLET JO KOMPETENTE në pikëpamje lëndore dhe HUDHET POSHTË SI E PALEJUAR, padia e paditëses H.G, C. nr. 3845/24 e datës 12.09.2024, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës– Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me objekt kontesti kompensim i diferencës në pension për shkak të inflacionit.

A r s y e t i m

Paditësja H.G nga Vushtrria, përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate me datë 12.09.2024, ka parashtruar padi kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të kompensimit të diferencës në pension për shkak të inflacionit, për periudhën nga data 01.01.2021 e deri me datë 31.03.2024, t’ia paguaj shumën prej 246.78 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data e

parashtrimin të padisë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 125.00 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit.

Gjykata, pasi bëri shqyrtimin paraprak të padisë dhe shkresave të lëndës, gjeti se çështja e cila është objekt i kësaj padie, përfaqëson çështje administrative, për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e këtij kontesti është kompetent Organi administrativ, përkatësisht Departamenti përkatës për pensione në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Sipas Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, me nenin 13 është përcaktuar se *“Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave, me vendim të veçantë, do të vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve të përcaktuara me këtë ligj.”*. Ndërsa me nenin 14 par. 4 pika e të njëjtit ligj përcakton se *“Ministria e Financave, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 2002/1 mbi metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensionit bazë në Kosovë, do të jetë përgjegjëse për llogaritjet që kërkohen nga ky ligj dhe për përcaktimin e nivelit të rritjes së pagesave të pensioneve të përcaktuara me këtë ligj*. Tutje, neni 18 par. 1 i të njëjtit Ligj përcakton se *“Departamenti përkatës për pensione i Ministrisë, është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj*. Kurse me nenin 19 par. 1 të këtij Ligji përcaktohet se *“Të drejtën në pension parashtruesi i kërkesës e realizon përmes parashtrimin të kërkesës në Ministri.”*

Tutje me Ligjin nr. 08/l-176 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e tyre me Ligjin Nr. 05/l-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me kapitullin XVII është bërë Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit Nr. 04/l-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, ku në nenin 62 përcaktohet se *Neni 19 i Ligjit bazik ndryshohet si dhe pas nenit 19 shtohen edhe dy nene të reja, 19A dhe 19B si në vijim: Neni 19 Parashtrimi i kërkesës “Të drejtën në pension parashtruesi i kërkesës e realizon përmes parashtrimin të kërkesës në Ministri. Mënyra dhe forma e parashtrimin të kërkesës bëhet në pajtim me dispozitat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Neni 19A Afati për marrjen e vendimit Procedura administrative e filluar sipas kërkesës sipas nenit 19 përfundohet brenda afatit prej dyzet e pesë (45) ditësh. Neni 19B E drejta e ankesës 1. Kundër secilit vendim përfundimtar të nxjerr sipas Ligjit bazik lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme*

*Administrative. 2. Kundër vendimeve të lëshuara në procedurë të inspektimit sipas këtij Ligji lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative. 3. Organ epror që shqyrton ankesat sipas këtij neni është Komisioni i ankesave i themeluar me vendim të Ministrit të Ministrinë përgjegjëse për punë dhe mirëqenie sociale. Ministri përkatës me Akt nënligjor përcakton përbërjen e komisionit dhe mandatin e anëtarëve të komisionit, i cili nxjerrët tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji. Puna dhe procedura e komisionit të ankesave bazohet në rregullat e përcaktuara për organet kolegjiale në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Në kuptim të dispozitave të cituara më lartë, kjo gjykatë vlerëson çështja e pensioneve është kompetencë e organeve administrative, përkatësisht e Departamentit përkatës për pensione i cili funksionon në kuadër të Ministrinë së Financave, Punës dhe Transfereve. Së këndejmi, kërkesa e paditëses për mbrojtje gjyqësore sipas padisë nuk mund të realizohet në procedurë kontestimore për faktin se lidhur me kontestin e natyrës së tillë, gjykatës i mungon kompetenca gjyqësore për vendosje për çështjen e ngritur me padi.

Në këtë mënyrë, gjykata vlerëson se janë plotësuar prezumimet procedurale që të veprohet në kuptim të dispozitës së nenit 18 par.2 të LPK-së, e cila përcakton se “Kur gjykata gjatë procedimit të çështjes konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata veçse ndonjë organ shtetëror tjetër, do të shpallet inkompetente, do t’i shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur”. Lidhur me këtë, dispozita e nenit 391 pika a) përcakton se “Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: a) çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore”.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, rezulton se kjo gjykatë është jo kompetente për vendosjen lidhur me kërkesën e paditëses, prandaj për këtë arsye, e në bazë të neneve 17, 18, 19, 29 dhe lidhur me nenin 391 par. 1 pika “a” e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C. nr.3845/24, me datë 08.11.2024

Numri i lëndës: 2024:309015  
Datë: 09.11.2024  
Numri i dokumentit: 06429843

Gj y q t a r i  
Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.